

Maj 2023



Rrjeti POP

Përballja e Ofertave Politike

Rrjeti “Përballja e Ofertave Politike – POP”, synon të rrisë debatin publik dhe informacionin te qytetarët si dhe orientimin e platformave drejt nevojave dhe prioriteteve të tyre. Përmes aktiviteteve rrjeti synon të forcojë demokracinë shqiptare, duke nxitur transparencën dhe llogaridhënien. Përballja e Ofertave Politike - POP, është një nismë e rrjetit të organizatave të shoqërisë civile shqiptare mbështetur nga “Olof Palme International Center” dhe “National Endowment for Democracy.”

Në kontekstin e zgjedhjeve vendore të 14 Majit 2023, Rrjeti POP ka organizuar 16 Forume Publike mes kandidatëve të forcave të ndryshme politike dhe qytetarëve. Në këto forume publike, Rrjeti POP ka prezantuar Kontratën Sociale për secilën Bashki, një platformë që synon të mbështesë qytetarët në përcaktimin e prioriteteve të tyre dhe të sigurojë angazhimin e kandidatëve për t'i ndjekur ato pas zgjedhjeve.

Gjatë forumeve publike të organizuara nga Rrjeti POP u jepet mundësia qytetarëve për të marrë informacion nga kandidatët dhe partitë politike në një mënyrë të hapur dhe transparente, ndërkohë që platforma e Kontratës Sociale për secilën Bashki siguron se prioritete të rëndësishme të qytetarëve do të jenë në qendër të fushatës elektorale dhe të qeverisjes së ardhshme.

POP mbi zgjedhjet vendore
Përmbledhje

Grupe diskutimi me qytetarët për
hartimin e Kontratave Sociale

Forumet Publike mes kandidatëve
dhe qytetarëve në kuadër të
Kontratës Sociale

POP në zgjedhjet vendore

Përmbledhje

Rrjeti Përballja e Ofertave Politike (Rrjeti POP) është një nismë e 12 organizatave lokale të shoqërisë civile, të pavarura, të cilat synojnë të rrisin debatin publik dhe informacionin te qytetarët gjatë periudhave zgjedhore, si dhe orientimin e platformave politike drejt nevojave dhe prioriteteve të qytetarëve.

Në muajt e parë të vitit 2023, Rrjeti POP krijoi një platformë të hapur dhe të pavarur, ku rreth 1000 qytetarë nga zonat rurale dhe urbane (në bashkitë Tiranë, Durrës, Vlorë, Fier, Kukës, Shkodër, Vau i Dejës, Pukë, Elbasan dhe Korçë) diskutuan mbi nevojat dhe prioritetet e tyre në 62 tryeza diskutimi. Prioritetet e qytetarëve të secilës bashki u pasqyruan në 10 (dhjetë) Kontrata Sociale. Kontratat Sociale u bazuan në katër fusha kryesore: (i) Demokracia Vendore dhe Mirëqeverisja; (ii) Drejtësia Sociale; (iii) Zhvillimi Ekonomik Vendor; (IV) Infrastruktura dhe Shërbimet Publike.

Pas hartimit të Kontratave Sociale, të gjitha partitë politike dhe kandidatët e tyre në 10 bashki të vendit, morën ftesë të merrnin pjesë në forumet publike të Rrjetit POP. Forumet publike që organizohen në kuadër të zgjedhjeve vendore 2023 kanë për qëllim të nxisin kulturën demokratike dhe synojnë të sigurojnë një hapësirë të hapur dhe të barabartë për përfaqësuesit e partive politike për të paraqitur platformat e tyre dhe për të diskutuar me qytetarët mbi Kontratat Sociale dhe shqetësimet e tyre.

Megjithë përpjekjet e anëtarëve të Rrjetit POP, jo të gjitha partitë politike shqiptare patën vullnetin politik për të realizuar përballje mes kandidatëve për kryetarë bashkie. Në këto kushte Rrjeti POP vazhdoi misionin e tij, duke mundësuar forume individuale mes qytetarëve dhe kandidatëve për kryetarë bashkie që përfaqësonin forcat më të mëdha politike në vend, duke vënë në plan të parë interesat e qytetarëve dhe adresimin e problemeve të tyre të cilat kërkojnë vëmendje të shtuar.

Gjatë periudhës prill-maj 2023, Rrjeti POP organizoi 16 forume publike në nëntë bashki, ku kandidatët/et për kryetarë/e bashkie diskutuan mbi prioritetet qytetare të Kontratës Sociale. Pesëmbëdhjetë (15) Kontrata Sociale u firmosën nga kandidatët si një angazhim moral i tyre për të adresuar prioritetet e qytetarëve. Përmes realizimit të forumeve publike për Kontratat Sociale, rrjeti POP tregoi që është i vetmi rrjet organizatash lokale që arriti të vendosë kandidatët për kryetarë bashkie përballë qytetarëve, me qëllim që prioritetet e qytetarëve të adresohen në axhendat e të zgjedhurve vendorë. Aktivitetet e POP 2023 ishin ndër të vetmet aktivitete ku qytetarët gjetën një mjedis të lirë nga politika dhe patën mundësi të shprehen në lidhje me shqetësimet e tyre në nivel vendor.


Realizimi i forumeve dhe nënshkrimi i Kontratave Sociale është vetëm hapi i parë i procesit: Gjatë katër viteve të ardhshme, bashkitë do të monitorohen nga organizatat e Rrjetit POP mbi progresin e realizimit të prioriteteve të identifikuara nga qytetarët.

Klikoni [këtu](#) për të lexuar Deklaratën Publike me gjetjet dhe konkluzionet



Grupet e diskutimit me qytetarët Hartimi i Kontratës Sociale 2023-2027

Si çdo periudhë para zgjedhjeve vendore, organizatat e Rrjetit POP gjatë periudhës shkurt – mars 2023 organizuan 62 grupe diskutimi me pjesëmarrjen e rreth 1000 qytetarëve të njësive administrative urbane dhe rurale në bashkitë: Tiranë, Durrës, Vlorë, Fier, Kukës, Shkodër, Elbasan, Vau i Dejes, Pukë dhe Korçë.



Qëllimi i këtyre grupeve të diskutimit me qytetarët ishte të pasqyrojnë prioritetet e tyre në nivel vendor dhe nevojat parësore në përditshmërinë e tyre për hartimin e Kontratës Sociale në secilën bashki.

Grupet e diskutimit u mbështetën në katër fusha kryesore:

- Demokracia vendore dhe mirëqeverisja:** Kjo shtyllë fokusohet në përfshirjen e qytetarëve në proceset vendimmarrëse.
- Drejtësia sociale:** Kjo shtyllë fokusohet në sigurimin e shanseve të barabarta dhe të drejtave të qytetarëve në fushat e shërbimeve sociale, arsimit, shëndetësisë, kulturës, etj., si dhe në luftën kundër diskriminimit dhe të gjitha formave të padrejtësisë sociale.
- Zhvillimi ekonomik vendor:** Kjo shtyllë fokusohet në zhvillimin e ekonomisë vendore dhe në ngritjen e kapaciteteve lokale për t'i dhënë impuls ekonomisë, rritjen e vendosjes së bizneseve dhe krijimin e vendeve të reja të punës.
- Infrastruktura dhe Shërbimet publike:** Kjo shtyllë fokusohet në sigurimin e shërbimeve publike cilësore, si uji i pijshëm, kanalizimet, pastrimi dhe menaxhimi i mbetjeve dhe në sigurimin e infrastrukturës së nevojshme për të ndihmuar qytetarët të jetojnë në një mjedis të sigurt dhe të shëndetshëm.

Këto katër fusha mbështeten në filozofinë e zhvillimit të qëndrueshëm duke siguruar që zhvillimi i qytetit të jetë koherent në aspektet sociale, ekonomike dhe mjedisore.

Grupet e diskutimit me qytetarët Hartimi i Kontratës Sociale 2023-2027

Nëpërmjet grupeve të diskutimit, u hartuan 10 (dhjetë) Kontrata Sociale të personalizuar për secilën bashki. Këto kontrata u hartuan me pjesëmarrjen e një sërë individeve nga grupmoshat dhe kategoritë e ndryshme sociale. Grupet ishin të përbërë nga gra, burra, vajza dhe djem të moshave të ndryshme, me nivele të ndryshme të arsimit dhe punës, si dhe nga individë të moshuar, me aftësi të kufizuara, gra viktima të dhunës në familje, familje që përfitojnë ndihmë ekonomike, si dhe gra kryefamiljare dhe jetimë.



Në secilin grup, qytetarët diskutuan për nevojat dhe shqetësimet e tyre në lidhje me jetesën në nivel vendor dhe u dha mundësia që të ndajnë ide dhe mendime për të përmirësuar kushtet e tyre sociale dhe jo vetëm. Në përgjithësi, pjesëmarrja e grupeve të ndryshëm në hartimin e Kontratave Sociale ndihmoi për të krijuar një qasje të ndryshme dhe të diversifikuar për të adresuar nevojat e një game të gjerë të qytetarëve. Kjo ndihmoi për të siguruar se kontratat ishin të përshtatshme për secilën kategori të komunitetit, duke i bërë ato më të efektshme në mbrojtjen dhe mbështetjen e tyre.



Kontrata Sociale 2023-2027

Qytetarët në pothuajse të gjitha bashkitë përcaktuan se prioritetet kryesore ishin forcimi i demokracisë vendore dhe angazhimi qytetar; drejtësia sociale; transporti publik i aksesueshëm dhe i sigurtë; si edhe nxitja e zhvillimit të qëndrueshëm vendor sidomos për të rinjtë dhe gratë.

DURRËS



Prioritetet kryesore: Forcimi i demokracisë vendore dhe avancimi i agjendës së integritit evropian në nivel vendor; Drejtësia Sociale; Rivitalizimi i Bibliotekës Publike.

Në bashkinë Durrës, Kontrata Sociale dhe monitorimi i saj realizohet nga “Qendra e Zhvillimit të Shoqërisë Civile” (CSDC). CSDC promovon dhe mbështet zhvillimin e shoqërisë civile në rajonin e Durrësit përmes mbështetjes, mobilizimit dhe duke sjellë së bashku aktorët më të rëndësishëm nga shoqëria civile dhe qeverisja vendore. CSDC është shumë efektive në koordinimin dhe fuqizimin e organizatave të shoqërisë civile dhe aktorëve të rajonit të Durrësit, duke u fokusuar tek të rinjtë dhe barazia gjinore.



Klikoni [këtu](#) për të lexuar Kontratën Sociale Durrës

ELBASAN



Prioritetet kryesore: Forcimi i demokracisë vendore dhe avancimi i agjendës së integritit evropian në nivel vendor; Drejtësia Sociale; Nxitja e zhvillimit të qëndrueshëm vendor .

Në bashkinë Elbasan, Kontrata Sociale dhe monitorimi i saj realizohet nga Shoqata “Tjetër Vizion”. Tjetër Vizion është një organizatë me eksperiencë 20 vjeçare në fushën e mbrojtjes dhe promovimit të të drejtave të njeriut dhe ofrimit të shërbimeve sociale për target grupet në nevojë.



Klikoni [këtu](#) për të lexuar Kontratën Sociale Elbasan

Kontrata Sociale 2023-2027

Qytetarët në pothuajse të gjitha bashkitë përcaktuan se prioritetet kryesore ishin forcimi i demokracisë vendore dhe angazhimi qytetar; drejtësia sociale; transporti publik i aksesueshëm dhe i sigurtë; si edhe nxitja e zhvillimit të qëndrueshëm vendor sidomos për të rinjtë dhe gratë.

FIER



Prioritetet kryesore: Strategji komunikimi, si domosdoshmëri për forcimin e demokracisë në nivel vendor, në shërbim të avancimit të agjendës së integritit evropian; Këshillim dhe bashkëqeverisje me Komunitetin; Mbështetje për të rinjtë

Në bashkinë Fier, Kontrata Sociale dhe monitorimi i saj realizohet nga Qendra “Epoka e Re”, e cila që prej vitit 2006 funksionon si organizatë jo-fitimprurëse me seli në Fier, por me shtrirje aktiviteti në të gjithë Shqipërinë. Qëllimi i organizatës është mbështetja e procesit të ndryshimeve sociale, zhvillimit, progresit demokratik dhe përmirësimit të jetës së komunitetit, nëpërmjet bashkëpunimit me të rinjtë.



Klikoni [këtu](#) për të lexuar Kontratën Sociale Fier

KORÇË



Prioritetet kryesore: Forcimi i demokracisë vendore dhe avancimi i agjendës së integritit evropian në nivel vendor; Nxitja e zhvillimit të qëndrueshëm vendor; Drejtësia Sociale.

Në bashkinë Korçë, Kontrata Sociale dhe monitorimi i saj realizohet nga Gruaja në Zhvillim Korçë (GZHK). GZHK është një organizatë jo-fitimprurëse, e cila ka filluar aktivitetin e saj në korrik 2003 si një lëvizje komunitare. Ka një përvojë të gjerë në fushën e çështjeve gjinore, në punën me të rinjtë, në fushën e qeverisjes së mirë, monitorimin e buxheteve të bashkive, në advokimin për drejtësi dhe barazi. Ajo është e angazhuar për advokim të përgjegjshëm, që ka si pikënisje komunitetet, me qëllim që zëri i tyre të dëgjohet, duke i inkurajuar ata për të qenë pjesë aktive në komunitetet ku ata jetojnë.



Klikoni [këtu](#) për të lexuar Kontratën Sociale Korçë

Kontrata Sociale 2023-2027

Qytetarët në pothuajse të gjitha bashkitë përcaktuan se prioritetet kryesore ishin forcimi i demokracisë vendore dhe angazhimi qytetar; drejtësia sociale; transporti publik i aksesueshëm dhe i sigurtë; si edhe nxitja e zhvillimit të qëndrueshëm vendor sidomos për të rinjtë dhe gratë.

KUKËS



Prioritetet kryesore: Forcimi i demokracisë vendore dhe avancimi i agjendës së integritit evropian në nivel vendor; Fuqizimi, përfshirja dhe mbështetja e të rinjve; Rivitalizimi i qendrës kulturore.

Në bashkinë Kukës, Kontrata Sociale dhe monitorimi i saj realizohet nga Qendra për Progres Rinor (QPR). QPR është një organizatë lokale që operon në Kukës prej 22 vitesh e fokusuar kryesisht në fushën rinore, ku synon të mbështesë dhe të ndihmojë grupet lokale rinore formale dhe joformale drejt programeve rinore, nismave për zhvillimin e të rinjve dhe të punojë ngushtë me palët e interesuara për të promovuar shërbime cilësore për të rinjtë.



Klikoni [këtu](#) për të lexuar Kontratën Sociale Kukës

PUKË



Prioritetet kryesore: Forcimi i demokracisë vendore dhe avancimi i agjendës së integritit evropian në nivel vendor; Nxitja e zhvillimit të qëndrueshëm vendor; Drejtësia Sociale.

Në bashkinë Pukë, Kontrata Sociale dhe monitorimi i saj realizohet nga Lëvizja Rinore për Demokraci (LRD). LRD është një organizatë joqeveritare, jopolitike, jofetare dhe jofitimprurëse që nxit aktivizimin qytetar, rritjen e demokracisë lokale dhe kontribuon në përmirësimin e jetës shoqërore e publike të komunitetit në Bashkinë Pukë dhe Fushë Arrëz nëpërmjet programeve të edukimit, ndërgjegjësimit, rritjes së kapaciteteve dhe avokimit.

Klikoni [këtu](#) për të lexuar Kontratën Sociale Pukë

Kontrata Sociale 2023-2027


Qytetarët në pothuajse të gjitha bashkitë përcaktuan se prioritetet kryesore ishin forcimi i demokracisë vendore dhe angazhimi qytetar; drejtësia sociale; transporti publik i aksesueshëm dhe i sigurtë; si edhe nxitja e zhvillimit të qëndrueshëm vendor sidomos për të rinjtë dhe gratë.

SHKODËR



Prioritetet kryesore: Forcimi i demokracisë vendore dhe avancimi i agjendës së integritit evropian në nivel vendor; Nxitja e zhvillimit të qëndrueshëm vendor; Drejtësia Sociale.

Në bashkinë Shkodër, Kontrata Sociale dhe monitorimi i saj realizohet nga Intelektualët e Rinj Shpresë (IRSH). IRSH është një shoqatë social-kulturore, e pavarur, jo-politike dhe jofitimprurëse, themeluar që prej vitit 1994 dhe punon për zhvillimin e shoqërisë civile në Shqipëri. Organizata përfaqëson intelektualë, të rinj dhe të reja, si edhe grupe të ndryshme nga organizatat e shoqërisë civile.



Klikoni [këtu](#) për të lexuar Kontratën Sociale Shkodër

TIRANË



Prioritetet kryesore: Forcimi i demokracisë vendore dhe avancimi i agjendës së integritit evropian në nivel vendor; Nxitja e zhvillimit të qëndrueshëm vendor; Drejtësia Sociale

Në bashkinë Tiranë, Kontrata Sociale dhe monitorimi i saj realizohet nga “Qendra Aleanca Gjimore për Zhvillim” (GADC) e cila operon që prej vitit 1995. GADC është një organizatë lider në Shqipëri dhe në Ballkanin Perëndimor me rezultate të suksesshme në mbrojtjen e të drejtave të njeriut, promovimin e barazisë gjinore dhe demokracisë me pjesëmarrje në shoqërinë shqiptare. Organizata punon për avancimin e të drejtave të njeriut nga perspektiva e barazisë dhe drejtësisë gjinore përmes veprimeve gjinore, zhvillimit të politikave dhe analizave gjinore.



Klikoni [këtu](#) për të lexuar Kontratën Sociale Tiranë

Kontrata Sociale 2023-2027

Qytetarët në pothuajse të gjitha bashkitë përcaktuan se prioritetet kryesore ishin forcimi i demokracisë vendore dhe angazhimi qytetar; drejtësia sociale; transporti publik i aksesueshëm dhe i sigurtë; si edhe nxitja e zhvillimit të qëndrueshëm vendor sidomos për të rinjtë dhe gratë.

VAU I DEJËS



Prioritetet kryesore: Forcimi i demokracisë vendore dhe avancimi i agjendës së integritimit evropian në nivel vendor; Nxitja e zhvillimit të qëndrueshëm vendor; Drejtësia Sociale.

Në bashkinë Vau i Dejës, Kontrata Sociale dhe monitorimi i saj realizohet nga Qendra “Hapa të Lehtë”. “Hapa të Lehtë” është një organizatë që punon për të drejtat e njeriut, me fokus të veçantë të drejtat e grave. Hapa të Lehtë është e angazhuar për integrimin social të grave dhe vajzave në zonat rurale, nëpërmjet ofrimit të shërbimeve mbështetëse dhe komponentit të fuqizimit ekonomik.



Klikoni [këtu](#) për të lexuar Kontratën Sociale Vau i Dejës

VLORE



Prioritetet kryesore: Forcimi i demokracisë vendore dhe avancimi i agjendës së integritimit evropian në nivel vendor; Transport publik cilësor dhe i sigurtë; Nxitja e zhvillimit të qëndrueshëm vendor.

Në bashkinë Vlorë, Kontrata Sociale dhe monitorimi i saj realizohet nga Qendra Rinore e Vlorës (QRV). QRV është një organizatë jo-fitimprurëse që punon në rajonin e Vlorës, prej 1998, në interes të publikut duke respektuar të drejtat e njeriut dhe demokracinë. Organizata bazohet në parimet e drejtësisë dhe solidaritetit social dhe ekonomik, të pjesëmarrjes demokratike në jetën e komunitetit, të promovimit të të drejtave civile, shoqërore dhe njerëzore si dhe në vullnetarizëm.

Klikoni [këtu](#) për të lexuar Kontratën Sociale Vlorë



FORUMET PUBLIKE ME QYTETARËT DHE KANDIDATËT

Rrjeti POP organizoi 16 forume publike në nëntë bashki të ndryshme (Tiranë, Durrës, Vlorë, Fier, Kukës, Shkodër, Vau i Dejës, Pukë dhe Korçë), me qëllim që të ofronte një platformë për kandidatët e forcave politike të flasin për planet dhe programin e tyre. Në këto forume, kandidatët patën mundësi t'u përgjigjen pyetjeve të qytetarëve, të cilat ishin të lidhura me zgjidhjen e çështjeve të Kontratës Sociale të hartuar mbi prioritetet dhe kërkesat e komuniteteve respektive.

Këto forume u organizuan nga Rrjeti POP me qëllim për të inkurajuar dialogun publik dhe pjesëmarrjen aktive të qytetarëve në procesin e zgjedhjeve. Platforma e ofruar u përdor si një mjet i mirë për të nxitur debatin mbi politikat sociale dhe për të ndihmuar qytetarët të marrin vendime të informuara në lidhje me zgjedhjet e tyre.

Rreth **700 qytetarë** morën pjesë në forumet publike të organizuara në salla dhe rreth **20,000** qytetarë të bashkive respektive patën mundësinë t'i ndiqnin ato live në faqen zyrtare të Rrjetit POP dhe në mediat sociale të kandidatëve, duke u mundësuar qytetarëve lokalë të ndjekin debatin mes tyre dhe komunitetit sipas bashkive. Në të gjitha forumet publike të organizuara, të gjithë kandidatët që morën pjesë ishin të vendosur që të nënshkruanin Kontratën Sociale dhe prioritetet e përcaktuara nga qytetarët dhe ta pranonin atë si pjesë integrale të programit të tyre qeverisës, nëse ata do të fitonin zgjedhjet.

Në këto forume, 2 (dy) kandidatë të Partisë Demokratike të Shqipërisë nga 3 kandidatë që garonin gjithsej nga kjo forcë politike në 10 bashkitë ku veprojnë organizatat e rrjetit POP pranuan ftesën për të marrë pjesë në Forumet Publike në Tiranë dhe Vau i Dejës. Prania e tyre në këto forume ishte e rëndësishme për qytetarët e bashkive të tyre, të cilët u dhanë mundësinë kandidatëve të diskutojnë me ta për problematikat vendore dhe planet për zgjidhjen e tyre.



Tiranë: Klikoni [këtu](#) për të ndjekur Forumin Publik me z. Roland Bejko

🗨️ **NË MOS TI, KUSH?
NË MOS SOT, KUR?**

**- NGRIJE ZËRIN
NË ZGJEDHJET
VENDORE!** 🗨️



VAU I DEJËS: Klikoni [këtu](#) për të ndjekur Forumin Publik me znj. Klomentina Drini

FORUMET PUBLIKE ME QYTETARËT DHE KANDIDATËT

6 (gjashtë) kandidatë të Partisë Socialiste që garuan në zgjedhjet për kryetar bashkie në Shkodër, Durrës, Vau i Dejës, Korçë, Kukës dhe Vlorë pranuan të marrin pjesë në Forumet Publike të organizuara nga Rrjeti POP ku u përballën me qytetarët dhe u diskutuan problematikat vendore bazuar në Kontratat Sociale respektive.



DURRËS: Klikoni [këtu](#) për të ndjekur Forumin Publik me znj. Emiriana Sako



SHKODËR: Klikoni [këtu](#) për të ndjekur Forumin Publik me z. Benet Beci



VAU I DEJËS: Klikoni [këtu](#) për të ndjekur Forumin Publik me z. Kristian Shkreli



KORÇË: Klikoni [këtu](#) për të ndjekur Forumin Publik me z. Sotiraq Filo



KUKËS: Klikoni [këtu](#) për të ndjekur Forumin Publik me z. Safet Gjici



VLORË: Klikoni [këtu](#) për të ndjekur Forumin Publik me z. Ermal Dredha



FORUMET PUBLIKE ME QYTETARËT DHE KANDIDATËT

8 (tetë) kandidatë nga Koalicioni “Bashkë Fitojmë” që garuan në zgjedhjet për kryetar bashkie në Tiranë, Fier, Durrës, Shkodër, Pukë, Kukës, Vau i Dejës dhe Vlorë morën pjesë në Forumet Publike të organizuara nga Rrjeti POP ku u përballën me qytetarët dhe u diskutuan problematikat vendore bazuar në Kontratat Sociale respektive.



TIRANË: Klikoni [këtu](#) për të ndjekur Forumin Publik me z. Belind Këlliçi



FIER: Klikoni [këtu](#) për të ndjekur Forumin Publik me z. Edvar Kodheli



DURRËS: Klikoni [këtu](#) për të ndjekur Forumin Publik me z. Igli Cara



SHKODËR: Klikoni [këtu](#) për të ndjekur Forumin Publik me z. Bardh Spahia



PUKË: Klikoni [këtu](#) për të ndjekur Forumin Publik me z. Rrok Dodaj



KUKËS: Klikoni [këtu](#) për të ndjekur Forumin Publik me z. Admir Sinamati



VAU I DEJËS: Klikoni [këtu](#) për të ndjekur Forumin Publik me z. Zef Hila



VLORË: Klikoni [këtu](#) për të ndjekur Forumin Publik me z. Hysni Sharra

👉 **NË MOS TI, KUSH?**
NË MOS SOT, KUR?
- **NGRIJE ZËRIN**
NË ZGJEDHJET
VENDORE! 👈

” NË MOS TI, **KUSH?**
NË MOS SOT, **KUR?**

– **NGRIJE ZËRIN**
NË ZGJEDHJET
VENDORE! ”

Adresa: Rr."Abdyl Frasheri", P.10/1, Tirana, Albania

Tel: +355 (0) 422255514

Mobile: +355 69 61 20 169

Email: perballjaeofertavepolitike@gmail.com

Web: <https://popnetwork.al/>

